PROÇESVERBAL

Nga seanca e këshillit të mbajtur me 31.08.2023, e Enjte me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës, në prezencë të këshilltarëve.

Seancën e 21-të (njëzet e një) e hapi Kryetari i këshillit Bujar Baftijari, dhe prezantoi propozimin e rendit të ditës me nr. Arkivor 08-1239/1 në përbërje prej 6 pikave.

REND DITE

1. Miratimi i proçesverbalit të Seancës së 20-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës.

2. Propozim-Vendim për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për kriteret e përcaktimit të zonave në komunën e Zhelinës.

3. Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën Janar-Qershor/2023-të.

4. Propozim-Vendime mbi përcaktimin e nevojës për zgjerimin e dokumentacionit urbanistik planor me qëllim të harmonizimit të objekteve të ndërtuara pa leje.

5. Propozim-Vendime për miratimin e Programës vjetore për punë të shkollave fillore komunale, në territorin e komunës së Zhelinës, për vitin shkollor 2023/2024-të.

6. Shqyrtimi i kërkesës nr. 08-1232/1 i datës 23.08.2023-të, nga Elvedin Beluli f.Stremnicë, dhe Shqyrtimi i kërkesës nr.08-1233/1 i datës 23.08.2023-të, nga Bashkim Sulejmani f.Zhelinë.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Bashkim Limani.

Bashkim L: Propozoj që rendi i ditës të kaloj me dy pika edhe atë pika e parë Miratimi I proçesverbalit të Seancës së 20-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës, dhe pika e dytë, Propozim-Vendime për miratimin e Programës vjetore për punë të shkollave fillore komunale, në teritorin e komunës së zhelinës, për vitin shkollor 2023/2024-të.

Kryetari i këshillit propozimin e këshilltarit Bashkim L. e hodhi në votim, u votua unanimisht dhe konstatoi se Rendi i Ditës përbëhet nga 2 pika.

1. Miratimi I proçesverbalit të Seancës së 20-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, meqë nuk pati diskutim e hodhi në votim pikën e pare, u votua unanimisht.

2. Propozim-Vendime për miratimin e Programës vjetore për punë të shkollave fillore komunale, në teritorin e komunës së Zhelinës, për vitin shkollor 2023/2024-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori këshilltarja ElmedinaZeqiri.

Elmedina Z: **Kam vërejtje për të gjithë shkollat që t'i rregullojnë gabimet drejtshkrimore dhe t'i përpilojnë programet në bazë ligjore, dhe gabime teknike kanë tepër, t'i përmirësojnë këto gabime jo të vazhdojnë vit pas viti me të njëjtat gabime, përndryshe ne si këshill do t'i kthejmë ato**.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari e hodhi në votim këtë pikë, u votua unanimisht dhe konstatoi se kjo pikë kalon.

Nr. 08-1239/2
31.08.2023-të
Zhelinë

Procesverbalist
Albineta Alija

Këshilli i komunës sëZhelinës
Kryetar
Bujar Baftijari